STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 10 tetor 2013

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) JEP $200 MILIONE NE FONDE PER TE PERMBUSHUR NEVOJAT E KUJDESIT SHENDETESOR E TE SHERBIMEVE NJEREZORE QE REZULTOJNE NGA SUPER STUHIA SENDI (SANDY)

Dollarë federalë jepen për mbi 450 organizata për të mbuluar shpenzimet dhe për të ndihmuar riparimin dhe rindërtimin e mjediseve

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se $200 milionë janë dhënë për më shumë se 450 sigurues të kujdesit shëndetësor e shërbimeve njerëzore dhe organizatave të tjera me qendër në komunitete pas ndikimit të super stuhisë Sendi (Sandy).

"Pothuajse një vit pasi super stuhia Sendi (Sandy) goditi Nju Jorkun (New York), siguruesit e kujdesit shëndetësor e të shërbimeve njerëzore të Shtetit (State) vazhdojnë t'u shërbejnë komuniteteve që rimëkëmben nga stuhia, edhe ndërsa shumë nga vetë këto organizata ende janë duke u rimëkëmbur," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Ky financim do të ndihmojë siguruesit të mbulojnë kosto të konsiderueshme që rezultojnë nga stuhia, përfshirë riparime dhe rinovime të mjediseve të rëndësishme, shpenzimet e parimbursuara dhe shërbimet në vazhdim për banorët e prekur të Nju Jorkut (New Yorkers). Me financimet e sotme, jemi duke e drejtuar ndihmën tek njerëzit dhe komunitetet që kanë nevojë më shumë për të, në mënyrë që Shteti (State) në tërësi të mund të vazhdojë të ndërtohet më i fortë sesa më parë."

Fondi në Bllok federal për Shërbimet Sociale të super stuhisë Sendi (Sandy) (Superstorm Sandy Social Services Block Grant) synon te mbulojë shpenzimet e parimbursuara që rezultuan nga stuhia, përfshirë shërbimet sociale, shëndetësore dhe të shëndetit mendor për individë dhe për riparime, rinovim dhe rindërtim të mjediseve të kujdesit shëndetësor, mjediseve të higjenës mendore, mjediseve të kujdesit për fëmijët dhe mjediseve të tjera të shërbimeve sociale.

Fondet do të sigurojnë pothuajse $65 milionë për kosto të riparimit, rindërtimit dhe rinovimit që rezultuan nga super stuhia Sendi (Sandy); $52 milionë për kostot e funksionimit të parimbursuara gjatë dhe pas Sendit (Sandy); $72 milionë për shërbimet e vazhdueshme ose të reja për të përmbushur nevojat në vazhdim të banorëve të Nju Jorkut (New Yorkers) të prekur nga Sendi (Sandy); dhe $11 milionë për kosto të tjera që kualifikohen të shërbimeve shëndetësore dhe sociale.

Fondet do t'u jepen 464 organizatave në pritje të dokumentacionit të plotë të kostove që kualifikohen. Disa prej përfituesve përfshijnë:

Në të gjithë rajonin

- **$166,000 për Shpëtoni Fëmijët (Save the Children)** për të rimbursuar organizatën ndërkombëtare jo-fitimprurëse për krijimin e hapësirave të emergjencave dhe vendndodhjeve të ndihmës "Kujdesi i Sigurtë për Fëmijën-Miqësor për Fëmijën (Child Care Safe-Child Friendly)" për kujdesin për fëmijët brenda gjashtë strehave dhe duke u shërbyar 1,033 fëmijëve.

Long Ajlënd (Long Island)

- **$6.6 milionë për Spitalin e Komuniteteve të Nasos Jugor (South Nassau Communities Hospital)** për kostot e ndërtimit dhe të funksionimit për të krijuar një Qendër të Kujdesit Urgjent (Urgent Care Center) që do të vendoset në Long Biç (Long Beach) për të zëvendësuar një mjedis që u shkatërrua për shkak të super stuhisë Sendi (Sandy).
- **$1.4 milionë për Koalicionin për të Pastrehët e Long Ajlënd (Long Island Coalition for the Homeless)** për të bërë riparimet e nevojshme në një qendër të komunitetit që strehon 10 qendra jo-fitimprurëse që do të sigurojnë shërbime për personat e pastrehë, përfshirë veteranët e pastrehë.
- **$2.9 milionë për Qendrën Mjekësore Hebraike të Long Ajlënd (Long Island Jewish Medical Center)**, një kompleks prej 48 akrash që përfshin Spitalin Hebraik të Long Ajlënd (Long Island Jewish Hospital), Qendrën Mjekësore të Fëmijëve Stivën dhe Aleksandra Kohen (Steven and Alexandra Cohen Children's Medical Center) dhe Spitalin Zuker Hillsaid (The Zucker Hillside Hospital), për kostot e rimbursuara të funksionimit për strehimin dhe kujdesin për një valë pacientësh gjatë dhe pas uraganit Sendi (Sandy), si dhe mbajtjen e mirëqënies të pacientëve ekzistues të tyre dhe sigurimin e shërbimeve të vazhdueshme për banorët e Nju Jorkut (New Yorkers) të prekur nga Sendi (Sandy).
- **$2.2 milionë për Shoqatën për Jetesën e Pavarur të Bregut Jugor (South Shore Association for Independent Living Inc.)**, për të riparuar dhe rindërtuar një banesë të komunitetit që u dëmtua rëndë dhe për të krijuar një program të Administrimit të Rasteve dhe Shërbimeve të Rimëkëmbjes (Recovery Case Management and Services) që do të sigurojë këshillim mbështetës për të ndihmuar individët që vazhdojnë të rimëkëmben nga pasojat e vazhdueshme të super stuhisë Sendi (Sandy).
- **$2.1 milionë për Shëndetin e FEGS & Shërbimet Njerëzore (FEGS Health & Human Services)** për të rimbursuar qendrën jo-fitimprurëse për dëmtimin e një ndërtese banimi me 10 kate me 138 banesa për shtetasit e moshuar me të ardhura të pakta, njerëzit me pa-aftësi dhe njerëzit që janë të shurdhë ose kanë vështirësi të dëgjimit dhe për të siguruar shërbime për fëmijët e Long Ajlënd (Long Island) dhe për të rriturit me pa-aftësi të zhvillimit të prekur nga super stuhia Sendi (Sandy).

Qyteti i Nju Jorkut (New York City)

- **$22.3 milionë për Qendrën Mjekësore Langon të Universitetit të Nju Jorkut (New York University Langone Medical Center)** për kostot e pakompensuara të funksionimit të pësuara si rezultat i uraganit Sendi (Sandy) ndërsa u kujdes për pacientë të sëmurë rëndë dhe punoi për të rihapur mjediset e tyre.
- **$2.3 milionë për Spitalin dhe Qendrën Mjekësore Brukdeill (Brookdale Hospital and Medical Center)** për kostot e funksionimit të parimbursuara për të strehuar dhe për t'u kujdesur për banorët e azilit si dhe për pacientët e tjerë në ndërtesën kryesore të saj në Bruklin (Brooklyn) dhe për shpenzimet e pësuara për rinovimin dhe restaurimin e dy kateve në spital për t'i bërë ato gati për pacientët.
- **$2.6 milionë për Këshillin Shëndetësor të Sanset Park/Qendrat Luterane të Familjes (Sunset Park Health Council Inc. / Lutheran Family Centers)**, një qendër shëndetësore e komunitetit që kualifikohet nga pikëpamja federale në Bruklin (Brooklyn), për të siguruar ndihmë mjekësore, të shëndetit të sjelljes, edukimit shëndetësor dhe ndihmë klinike për popullsitë e prekura nga stuhia në nëntë projeke të strehimit publik në lagje në Koni Ajlënd (Coney Island).
- **$1 milionë për CAMBA për të financuar Projektin e Rimëkëmbjesë Fshatit të Oqeanit (Ocean Village Recovery Project)**, që do të trajtojë nevojat e menjëhershme të banorëve të kompleksit të Fshatit të Oqeanit (Ocean Village) në Gadishullin Rokëuej (Rockaway Peninsula) duke u siguruar banorëve të papunë dhe me punë jo të mjaftueshme shërbime për t'i lejuar të sigurojnë punësim me përfitim, duke përfshirë ndihmë në përdorimin e mundësive të trainimit për punë dhe vendosjen e drejtpërdrejtë në punë.
- **$482,000 për Qendrën Mjekësore të Universitetit të Riçmondit (Richmond University Medical Center)** për kostot e rimbursimit për të riparuar dëmin e madh të çatisë së godinës dhe elementëve të tjera të ekspozuara të ndërtesës si dhe kosto të parimbursuara të funksionimit të pësuara si rezultat i një vale pacientësh gjatë dhe pas uraganit Sendi (Sandy). Qendra Mjekësore e Universitetit të Riçmondit (Richmond University Medical Center) siguron shërbime thelbësore të kujdesit shëndetësor për një zone prej mbi 500,000 banorësh dhe ishte spitali i vetëm plotësisht funksional i kujdesit të shëndetit akut i hapur në Stejtën Ajlënd (Staten Island) gjatë super stuhisë Sendi (Sandy).
- **$446,000 për Projektin Mikëpritja (Project Hospitality)**, një organizatë që siguron ushqim, strehim dhe shërbime për më shumë se 26,000 banorë të varfër, të uritur dhe të pastrehë të Stejtën Ajlënd (Staten Island) në vit, për t'u lejuar që të vazhdojnë të sigurojnë shërbime thelbësore të rimëkëmbjes që përfshijnë sigurimin e ushqimit, strehimit dhe informacionit për mijëra banorë të Stejtën Ajlënd (Staten Islanders) të prekur nga uragani Sendi (Sandy).
- **$68,000 për Shtëpinë Hemilltën-Medisën (Hamilton-Madison House)** për të siguruar administrimin e rasteve, referime për shërbime të shëndetit mendor pas katastrofave/abuzimit me substancat, ndihmë me kërkesa për hua të Shoqatës së Biznesit të Vogël (Small Business Association) (SBA) dhe zëvendësimin e pajisjeve të shkatërruar nga Sendi (Sandy) në komunitetet e poshtme të Anës Lindor (East Side), përfshirë Çajnataun (Chinatown).

Mid-Hadsën (Mid-Hudson)

- **$257,000 për Fshatin e Fëmijëve (to The Children's Village)**, e cila u shërben mbi 10,000 fëmijëve dhe familjeve çdo vit nëpërmjet një shumëllojshmërie të programeve afat-shkurtër në qendër dhe në komunitet. Kompleksi i tyre i banimit në Qarkut Westçestër (Westchester County) pësoi dëmin më të konsiderueshëm nga super stuhia Sendi (Sandy) me çati të shkulura, pemë të rëna dhe gardhe të thyera.
- **$241,000 për Qendrën e Banimit të Fëmijëve Samit (The Summit Children's Residence Center)** në Niak. Qendra e Banimit e Fëmijëve (Summit Children's Residence) do t'a përdorë fondin për të riparuar dhe mirëmbajtur strukturat e dëmtuara nga super stuhia Sendi (Sandy) për të siguruar se janë në gjendje të përmbushin nevojat e 115 adoleshentëve me shqetësime të rënda emocionale në kujdesin e saj 24 orë në ditë, 365 ditë në vit.

Përfituesin e financimeve u përzgjodhën nëpërmjet një kërkesë për propozime konkurruese dhe transparente. Të gjitha përfitimet janë paraprake. Ndryshime mund të bëhen në raste të shpenzimeve të caktuara që nuk kualifikohen, dublikime të përfitimeve me rimbursime të tjera federale, shtetërore ose private dhe dokumentacion të pamjaftueshëm të kostove. Shteti i Nju Jorkut (New York State) gjithashtu mund të japë përfitime shtesë mbështetur në disponueshmërinë e fondeve.

Për një listë të plotë të caktimeve paraprake, shkoni te: www.Stormrecovery.ny.gov/SandySSBG

Bashkë-Udhëheqësi i Koalicionit të Shumicës në Senat Din Skelos (Dean Skelos) tha, "Ky fond është mjaft i rëndësishëm për të siguruar se banorët e Long Biçit (Long Beach) mund të përdorin shërbimet e kujdesit urgjent të siguruara nëpërmjet Spitalit të Komuniteteve të Nasos Jugor (South Nassau Communities Hospital) dhe Qendrës Mjekësore të Long Biç (Long Beach Medical Center). Këto fonde janë një hap i madh përpara drejt ndihmës për rimëkëmbjen e vazhdueshme të zonës sonë nga uragani Sendi (Sandy) që shkatërroi shërbimet e kujdesit shëndetësor në Long Biç (Long Beach)."

Bashkë-Udhëheqësi i Koalicionit të Shumicës në Senat Xhef Klain (Jeff Klein) tha, "Një vit pas super stuhisë Sendi (Sandy), angazhimi ynë për rindërtimin e Nju Jorkut (New York) mbetet më i fortë se kurrë. Këto organizata vazhdojnë të jenë disa nga aktorët më të rëndësishëm në terrën në zonat e goditura më rëndë të Nju Jorkut (New York). Jam krenar se mund të japim fondet që këto organizata kanë nevojë, në mënyrë që të mund të rindërtojnë dhe të vazhdojnë t'u shërbejnë komuniteteve në nevojë."

Kryetari i Asamblesë Sheldon Silvër (Sheldon Silver) tha, "Kur Nju Jorku (New York) u shkatërrua nga super stuhia Sendi (Sandy), unë dhe shumë nga kolegët e mi të Asamblesë punuan nga afër më organizatat tona vendore jo-fitimprurëse për të dhënë shërbimet thelbësore për ata që ishin në nevojë të dëshpëruar. Organizatat jo-fitimprurëse u afruan për të dhënë një dorë ndihme vendimtare për banorët dhe pronarët e bizneseve. Duke respektuar misionet thelbësore të tyre, kanë qënë organizatat tona jo-fitimprurëse, të kujdesit shëndetësor dhe të shërbimeve njerësore që kanë dhënë atë mbështetje gjatë vitit të kaluar. Në komunitetin tim të Manhatanit të Poshtëm (Lower Manhattan), organizatat vendore u hodhën në veprim, duke punuar pa pushim për të ndihmuar ata që ishin më të cënuar dhe kanë vazhduar të japin shërbime vendimtare. Pavarësisht nga vetë nevojat e tyre për të

riparuar dhe rindërtuar, organizatat jo-fitimprurëse të Nju Jorkut (New York) gjithnjë vendosën fqinjët e tyre të parët. I përgëzoj të gjithë ata për përkushtimin e vazhdueshëm të tyre ndaj komuniteteve tona dhe përgëzoj Guvernatorin Kuomo (Cuomo) për vlerësimin e përpjekjeve të më shumë se 450 organizatave me bazë në komunitet."

Riçard Mërfi (Richard Murphy), President dh CEO i Spitalit të Komuniteteve të Nasos Jugor (South Nassau Communities Hospital), tha, "Falënderoj Guvernatorin Endjur Kuomo (Andrew Cuomo) për fondin në Bllok të Shërbimeve Sociale (Social Services Block) që do të ndihmojë Spitalin në përkushtimin e tij për të ndihmuar në përmbushjen e nevojave të kujdesit shëndetësor të banorëve të tij që u prekën nga shkatërrimi i urganit Sendi (Sandy). Në veçanti, kjo do t'i lejojë Nasos Jugor (South Nassau) të çojë më tej angazhimin e tij ndaj banorëve të Long Biç (Long Beach) për të siguruar shërbime të kujdesit urgjent për komunitetin. Spitali i Komuniteteve të Nasos Jugor (South Nassau Communities Hospital) mezi pret që të vazhdojë punën e tij me Qendrën Mjekësore të Long Biç (Long Beach Medical Center) dhe Departamentin e Shëndetësisë të NYS (NYS Department of Health) në përmbushjen e këtij qëllimi."

Teri Troja (Terry Troia), Drejtor Ekzekutiv i Projektit Mikëpritja (Project Hospitality), me disa vendndodhje anembanë Stejtën Ajlënd (Staten Island), tha, "Që nga 1 nëntori 2012, kemi ndihmuar më shumë se 4,000 familje të prekura nga uragani Sendi (Sandy) dhe vazhdojmë të administrojmë qendrën e vetme ende në punë të evakuimit në NYC. Jemi mjaft të gëzuar dhe shprehim mirënjohjen tonë ndaj Guvernatorit Kuomo (Cuomo) dhe ekipit që shqyrtoi kërkesën tonë. Jemi mjaft të prekur nga ky fond i jashtëzakonshëm dhe e dimë se ndikimi i këtyre fondeve do të sjellë një ndryshim të vërtetë për të gjithë banorët e Stejtën Ajlënd (Staten Islanders)."

Greta Garton (Greta Guarton), Drejtoreshë Ekzekutive, Koalicioni për të Pastrehët i Long Ajlënd (Long Island Coalition for the Homeless), tha, "Jemi kaq mirënjohës ndaj Guvernatorit dhe Shtetit të Nju Jorkut (New York State) për këtë financim, që do të na lejojë të përfundojmë punën në një qendër për komunitetin që ishte shkatërruar nga super stuhia Sendi (Sandy). Pasi të jetë rinovuar ndërtesa, veteranët e pastrehë dhe banorët e tjerë të Long Ajlënd (Long Islanders) të pastrehë do të jenë në gjendje të përdorin një shumëllojshmëri shërbimesh, përfshirë ndihmën për strehimin dhe punësimin, në një model me "një ndalesë" të ofruar nga 10 organizata jo-përfituese të vendosura në ndërtesë."

Zhan-Eim de Mare (Jeanne-Aimée De Marrais), Këshilltare për Programet e Emergjencave të Brendshme të Shpëtoni Fëmijët (Save the Children), tha, "Ndihma e Guvernatorit nënkupton se kur fëmijët janë më të cënuarit – kur familjet e tyre humbën gjithshka dhe iu desh të kërkonin strehë në streha të mëdha të evakuimit (disa herë duke fjetur pranë qindra të huajve), Shpëtoni Fëmijët (Save the Children) ishte në gjendje të siguronte programe dhe të kujdesej për t'i mbajtur fëmijët të sigurtë. Jemi mirënjohës ndaj ndihmës së Guvernatorit Kuomo (Cuomo) që lejoi Shpëtoni Fëmijët (Save the Children) të ndihmojë në mbështetjen e mbrojtjes dhe rimëkëmbjes së fëmijëve kur ishin në streha të evakuimit menjëherë pas stuhisë kur banorët e Nju Jorkut (New Yorkers) kishin më shumë nevojë për të."

Mark I. Toni (Mark E. Toney), President dhe CEO i Spitalit dhe Qendrës Mjekësore Brukdeill (Brookdale Hospital and Medical Center), tha, "Si një spital i komunitetit, besimi thelbësor i Brukdeillit (Brookdale)

është se jemi këtu për të shërbyer. Pasi uraganit Sendi (Sandy), ishim të nderuar dhe krenarë që punuam me zyrën e Guvernatorit, DOH dhe GNYHA për të siguruar kujdes për komunitetet e gjëra dhe shtetasit më të cënueshëm të tyre në kohën e nevojës. Vlerësojmë udhëheqjen e Guvernatorit Kuomo (Cuomo) gjatë stuhisë. Përveç kësaj, sot, e çmojmë që ai vlerëson përpjekjet e Brukdeillit (Brookdale) dhe këto Fond në Bllok do të na ndihmojnë të mbulojmë disa prej kostove të jashtëzakonshme që pësuam gjatë asaj kohë mjaft të vështirë."

Kethi Timër-Kembëll (Kathy Teemer-Campbell), Këndi i Kujdesit të Kethit (Kathy's Korner of Care), tha, "Si pronare dhe operatore e një programi të vogël të kujdesit për fëmijën në Long Biç (Long Beach), biznesi im u shkatërrua nga super stuhia Sendi (Sandy). Shtëpia dhe vendi im i biznesit pësuan dëmtime të mëdha nga uji pasi ai arriti nivelin prej pesë këmbësh dhe shkaktoi një zjarr që dogji pothuajse të gjithë katin e parë. Kam qënë aq me fat pasi kam qënë në gjendje të funksionoj nga një vendndodhje tjetër, duke siguruar kujdes të rëndësishëm për fëmijën për familjet e tjera gjithashtu të prekura nga stuhia. Këto fonde do të më ndihmojnë mjaft që të riparoj shtëpinë time dhe të ringjall programin tim të kujdesit për fëmijën. Jam mirënjohëse për këtë mundësi për të riparuar dhe rindërtuar biznesin tim, shtëpinë time dhe jetën time."

Robert Aj Grosman (Robert I. Grossman), MD, Dekan dhe CEO I Qendrës Mjekësore Langon të NYU (NYU Langone Medical Center), tha, "Jemi mirënjohës ndaj të gjithë atyre që ndihmuan NYU Langon (NYU Langone) ndërsa jemi përpjekur të përmbushim nevojën e madhe për shërbime të kujdesit shëndetësor në komunitetin tonë. Veçanërisht dëshiroj të falënderoj Guvernatorin Endrju m. Kuomo (Andrew M. Cuomo) dhe zyrtarët e Shtetit të Nju Jorkut (New York State), përfshirë personelin e Departamenteve Shtetërore të Shëndetësisë (State Departments of Health) dhe të Sigurisë së Atdheut (Homeland Security). Kjo ndihmë do të jetë e dobishme për pacientët tanë dhe të gjithë qytetin, ndërsa NYU Langon (NYU Langone) punon për t'u rimëkëmbur nga ndikimi i madh i stuhisë."

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418